



www.legjislatiioni.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 16

---

Tiranë – E hënë, 2 nëntor 2015

---

## PËRMBAJTJA

|  | Faqe |
|--|------|
| Kërkesë e Ministrisë të Mirëqenies Për shprehje interesi.....<br>Sociale dhe Rinisë nr. 5548,<br>datë 29.10.2015 | 3    |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË

**KËRKESË  
PËR SHPREHJE INTERESI  
Nr. 5548, datë 29.10.2015**

PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË  
ASISTENCËS SOCIALE (SAMP),

**Shërbime konsulence**

**Për mbikëqyrje teknike (supervizimi),  
verifikimi dhe validimi i pavarur (IV&V) i  
zhvillimit dhe i zbatimit të sistemit të  
menaxhimit të informacionit (SMI) për  
programin e personave me aftësi të kufizuara  
(PAK)” - Ref. no. SAMP/CS/CQ/04-2014**

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale -  
(SAMP)

Hua nr. 8141- AL

Nr. i identifikimit të Projektit: P122233.

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (Shërbim) përfshin “Mbikëqyrje teknike (supervizimi), verifikimi dhe validimi i pavarur (IV&V) i zhvillimit dhe i zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për programin e personave me aftësi të kufizuara”.

Qëllimi i projektit sipas këtyre Termave të Referencës është të kryejë shërbimet e verifikimit dhe të validimit (IV&V) të projektit për zhvillimin e softuerit për SMI e PAK që do të zbatohet nga kontraktuesi i rekrutuar nga MMSR-ja.

Firma konsulente:

a) do të sigurojë një opinion teknik të pavarur për të verifikuar dhe për të vërtetuar produktet e dorëzuara nga konsulenti i zbatimit.

b) do të kryejë testet e nevojshme të verifikimit dhe të validimit, në mënyrë të pavarur nga testimi dhe QA e kryer nga konsulenti i zbatimit.

c) do të ofrojë një opinion teknik mbi punën e tyre.

Konsulenti do të sigurojë që SMI të PAK-ut i zhvilluar do të mbajë arkitekturën e nevojshme të

sistemit dhe funksionalitetin në përputhje të plotë me proceset operacionale dhe administrative të përcaktuara në bazë të ligjit shqiptar në fuqi për menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale për programin e Asistencës së Aftësisë së Kufizuar, siç përcaktohet në specifikimet teknike të përgatitura për zhvillimin e SMI të PAK-ut.

Konsulenti duhet të japë informacion me shkrim që të demonstrojë aftësinë dhe përvojën e tij në kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme:

- Zhvillimin dhe zbatimin e planit të IV&V në lidhje me një plan të zhvillimit të SMI-së.

- Shqyrtimin, analiza dhe rekomandime mbi planifikimin për hartimin dhe zbatimin SMI nga zhvilluesi dhe përmirësimet e rekomanduara për menaxhimin, aspektet organizative dhe teknike.

- Rishikimin dhe përmirësimin e përfshirjes së përdoruesit dhe *buy-in* në lidhje me funksionalitetin e sistemit dhe aftësinë e sistemit për të përmbushur nevojat e programit.

- Vlerësimi i rreziqeve që lidhen me zbatimin SMI dhe rekomandimi i një plani lehtësues.

- Zhvillimi i performancës *metrics* në lidhje me përfundimin e projektit SMI kundrejt objektivave të përcaktuar nga organizata e klientit.

Konsulencia do të kryhet nga një firmë lokale konsulente me përvojë të dëshmuar në zhvillimin, verifikimin e mbikëqyrjes dhe vlefshmërinë e projekteve të ngjashme në institucionet e administratës publike ose ndërmarrjet e ngjashme, me kompleksitet, vëllime të dhënash dhe kërkesa të sistemeve të integritetit të larta.

Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë nga dy ekspertë kryesorë me formimin e kualifikuar teknik dhe përvojën e demonstruar, në fushat e mëposhtme, si vijon:

1. Një ekspert kryesor për verifikimin dhe validimin (IV&V) të dizenjimit dhe të zbatimit të softuerit.

- Minimalisht të jetë një inxhinier i certifikuar për zhvillim sistemesh me një përvojë minimumi prej 7 vitesh në projektimin, zhvillimin dhe testimin e sistemeve softuer, duke përfshirë zbatimin e bazës së të dhënave.



- Të ketë përvojë dhe certifikatat në fushat e mëposhtme: i) menaxhimin e projekteve; ii) projektimit të sistemeve softuer; iii) zhvillimin e softuerit dhe testimin, duke përfshirë zbatimin e bazës së të dhënave; iv) IV& V e procesit dhe zbatimi i metodave.

- Ka përvojë auditimi IT dhe sigurimi IT.

- Të ketë menaxhuar zbatimin e sistemeve të informacionit, duke përfshirë, si vijon: i) përgjegjësia për zhvillimin e planit të detajuar të projektit; iii) ka menaxhuar një buxhet projektit me vlerë 150.000 euro apo më të madhe dhe me kohëzgjatje gjashtë muaj ose më shumë.

- Ka mbikëqyrur dhe kryer testimin dhe validimin e dy ose më shumë projekteve të zhvillimit të softuerit dhe të zbatimit të sistemit, të zhvilluar dhe të implementuar nga një palë e tretë, që përfshinte: i) një *web* bazuar në SMI me një bazë përdoruesish prej 100 përdorues; ii) menaxhimin e një bazë të madhe të dhënash; iii) përfshirë trajnimin e një baze përdoruesi në lokacione të ndryshme; dhe iv) ka përfunduar dhe dorëzuar me sukses projektet.

- Flet dhe shkruan rrjedhshëm gjuhën angleze.

2. Një ekspert kryesor për verifikimin dhe validimin (IV&V) e dizenjimit dhe të zbatimit të rrjetit të infrastrukturës dhe bazën e të dhënave.

- Minimalisht të jetë një inxhinier i certifikuar për projektimin e sistemeve me specializim në projektimin, zbatimin, testimin dhe mbikëqyrjen e harduerëve dhe rrjetit, me përvojë teknike të demonstruar, minimumi prej 7 vjetësh në ngritjen e infrastrukturës së sistemeve harduere.

- Të ketë përvojë dhe certifikatat në fushat e mëposhtme: i) hartimin dhe zbatimin e serverëve dhe ruajtjen e të dhënave; ii) krijimin e versioneve virtuale; iii) hartimin dhe sigurimin e infrastrukturës së rrjetit.

- Të ketë përvojë në auditimet IT dhe sigurimin IT.

- Të ketë menaxhuar zbatimin e *datacenter* dhe dizenjimin dhe zbatimin e infrastrukturës së rrjetit, duke përfshirë si vijon: i) përgjegjësia për zhvillimin e planit të detajuar të projektit; iii) ka menaxhuar një buxhetprojekt me vlerë 200.000 euro apo më të madhe dhe me kohëzgjatje gjashtë muaj ose më shumë. i dhe infrastrukturës së rrjetit *design* dhe zbatim, duke përfshirë si vijon: i) përgjegjësia për zhvillimin e planit të detajuar të projektit; iii) ka menaxhuar një buxhetprojekt me vlerë 200,000

euro ose më të madhe dhe me kohëzgjatje tre muaj ose më shumë.

- Ka mbikëqyrur dhe kryer testimin dhe vlefshmërinë e projekteve *datacenter* të cilat janë zhvilluar dhe implementuar me sukses.

- Flet dhe shkruan rrjedhshëm gjuhën angleze.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT) fton të gjithë kompanitë konsulente të pranueshme (konsulente) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet. Kriteret e shortlistimit dhe të vlerësimit janë:

1. Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit – (10 pikë);

2. Numri i shërbimeve/kontratave të kryera gjatë tri viteve të fundit - (10 pikë);

3. Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimi i ekspertëve kryesorë - (20 pikë);

4. Eksperienca dhe kualifikime të ngjashme me këtë shërbim të stafit kryesor - (50 pikë);

5. Numri i viteve të personelit kryesor në firmë - (10 pikë);

TOTALI - 100 pikë.

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore për: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA & Grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore (Udhëzuesi i Konsulencës)- version i janarit të 2011.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit për të forcuar kualifikimet e tyre.

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është “Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsulentit” – CQ, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimit e konsulentëve (botimi, janar 2011). Kohëzgjatja e shërbimit do të jetë brenda një periudhe 12-mujore.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00 - 16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00 -14:00 të premtën.



Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri në 11 nëntor 2015.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë–kati 1

Rruga e Kavajës, nr. 53, Tiranë, Albania

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli





Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.